

1011
24.6.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 5889/ prot.

Tiranë, më 20/06/2019

Lënda: Mbi urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.243, datë 12.06.2019

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

✓ Tiranë

Në kuadër të paktit me Universitetin Politeknik të Tiranës, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë në funksion të mbështetjes dhe rritjes së potencialeve financiare të këtij universiteti, ka proceduar me nxjerrjen e urdhrin nr.243, datë 12.06.2019 “Për një ndryshim në urdhrin nr.197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

Nëpërmjet urdhrin të lartpërmendur, Universitetit Politeknik të Tiranës i krijohet mundësia të krycjë oponencën teknike për të gjitha projektet (objektet) publike të veprave të ndërtimit, për të cilat kryerja e oponencës teknike është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Ju lutem bashkëlidhur gjeni një kopje të urdhrin nr.243, datë 12.06.2019 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,

MINISTËR
Belinda Balluku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. prot. _____

datë _____ 2019

URDHËR

Nr. 243 datë 12.06 2019

“PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.197, DATË 09.10.2014 “PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË MARRËVESHJES PËR KRYERJEN E Oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar); ligjit nr.9000, datë 30.1.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin me nr.197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, të bëhen ndryshimet si vijon:
 - a. Pika 1, ndryshon me përmbajtjen si vijon: “Për të gjitha projektet (objektet) publike të veprave të ndërtimit, për të cilat kryerja e oponencës teknike është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi, oponenca teknike të kryhet nga Instituti i Ndërtimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës”;
 - b. Në pikën 2 togfjalëshi “Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit” zëvendësohet me togfjalëshin “Universiteti Politeknik i Tiranës”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Belinda Balluku